



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E APELIT DURRËS

NJOFTIM PËR VEND VAKANT

Njoftim për vënd të lirë pune në administrat në pozicionin “kryesekretares”, në Prokurorinë e Apelit Durrës

Bazuar në nenin 42 gërma “a”, 57, të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm, nr.21, datë, 29.01.2020 “Për strukturën organike të Prokurorive të Shkallës Parë, dhe Prokurorive të Apeleve, ligjit 10296, date 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndryshuar me ligjin 110, datë 15.10.2015, si dhe pas dorëheqjes së kryesekretares në Prokurorinë e Apelit Durrës, me qëllim plotësimin e vendit vakant në këtë pozicion shpall njoftimin;

Kërkesat e përgjithshme për kandidatët

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar.

Kërkesat e vecanta për kandidatët

1. Të jete diplomuar ne shkenca ekonomike - dega Financë, niveli master shkencor ose të barasvlefshem me të.
2. Te kete pervoje profesionale jo më pak se tre vjet ne fushën e kontabilitetit dhr /ose menaxhimit te buxhetit.
3. Të njohi dhe perdori shume mire programin alfa.
4. Prioritet është të ketë punuar në sistemin e drejtësisë.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjithë kandidatët si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- a. Jetëshkrimin;
- b. Kërkesë për aplikim
- c. Fotokopje të diplomës;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- e. Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimit brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- f. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- g. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- h. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Data e dorëzimit të dokumentave: 23.04.2021

Konkurrimi për vendin e punës kryesekretar, do të bazohet në:

1. Ligjin nr.97/2016, "Per organizimin e funksionimit e Prokurorisë së Përgjithshme;
2. Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
3. Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar,
4. Ligjin nr.10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"
5. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,
6. Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar,
7. Ligjin nr.7961 datë.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

I. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me gojë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- Për vlerësimin e jetëshkrimit (cv) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, **15 pikë**;
- Për vlerësimin me shkrim, **60 pikë**.
- Për intervistën e strukturuar me gojë, **25 pikë**;

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email-, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ambjenteve të Prokurorisë së Apelit Durrës.

Per cdo mformacion me te hollësishem gjithë te interesuarit te paraqiten në Prokurorine Prane Gjykates se Apelit Durrës.

PROKURORIA E APELIT DURRËS

DURRËS MË 07.04.2021